



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KUVENDI
Komisioni për Ekonominë dhe Financat

PROCESVERBAL

Tiranë, më 06.11.2018, ora 11:00

Drejton mbledhjen:

Erion Braçe – kryetar i Komisionit

Rendi i ditës:

1. Miratimi i procesverbalit.
2. Prezantim, nga Ministri i Financave dhe Ekonomisë, në Komisionin për Ekonominë dhe Financat i projektligjeve të paketës fiskale;
3. Paraqitja e raportit të relatorit të Komisionit, në parim, për projektligjet e paketës fiskale.

Marrin pjesë:

Erion Braçe, Anastas Angjeli, Evis Kushi, Antoneta Dhima, Blerina Gjylameti, Ilir Xhakolli, Xhevit Bushaj, Arben Pëllumbi, Reme Lala, Ervin Bushati dhe Roland Xhelilaj.

Mungojnë:

Jorida Tabaku, Edmond Spaho, Agron Shehaj, Fatbardha Kadiu, Nadire Meçorapaj, Dashamir Shehi, Edmond Haxhinasto dhe Përparim Spahiu.

Të ftuar:

Arben Ahmetaj - Ministër i Financave dhe Ekonomisë
Gelardina Prodani- Sekretare e Përgjithshme, Ministria Financave dhe Ekonomisë
Mimoza Dhëmbi - Drejtoreshë e Përgjithshme e Buxhetit në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë
Nikolla Lera - Drejtor i Përgjithshëm i Politikave Makroekonomike në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

Endrit Lami – Drejtor në Drejtorinë e Politikave Makroekonomike në Ministrinë e
Financave dhe Ekonomisë

Alba Caroshi – Këshilltare në Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë

HAPET MBLEDHJA

Erion Braçe – Fillojmë mbledhjen e Komisionit të Ekonomisë dhe Financave. Siç dhe jeni njoftuar, sot në rendin e ditës së punës së këtij komisioni është prezantimi në parim i paketës fiskale, pra i të shtata ligjeve, si dhe prezantimi i raportit të relatorit të komisionit lidhur me këto projektligje.

Për të prezantuar paketën fiskale, në Komisionin e Ekonomisë është i pranishëm Ministri i Financave dhe Ekonomisë, ndërkohë që relatorë i komisionit, lidhur me paketën fiskale, janë zonja Blerina Gjylameti dhe zoti Ervin Bushati.

Do të procedojmë me prezantimin e paketës fiskale nga ana e ministrit, pastaj me relatorët e komisionit. Më pas do të ketë pyetje e diskutime.

Zoti Ministër, fjala për ju!

Arben Ahmetaj – Faleminderit!

Përpara se të filloj me prezantimin, ju kërkoj ndjesë për vonesën, sepse pas seancës parlamentare u bë një mbledhje qeverie, e cila ishte e paparashikuar. Kësisoj, ju lutem, ma merrni parasysh ndjesën, pasi ishte diçka e paplanifikuar.

Përgjatë dy mandateve të para, qeveria “Rama” ka ndërmarrë një sërë masash fiskale, të orientuara nga parimi bazë me të cilin erdhëm në qeveri: progresiviteti dhe taksimi i ndershëm. Kjo sipas parimit: kush fiton më shumë, paguan më shumë, dhe kush fiton më pak paguan më pak.

Gjatë këtyre viteve, politikat tona fiskale kanë synuar dhe mundësuar uljen e barrës fiskale për sipërmarrjen dhe qytetarët, përmirësimin dhe thjeshtësimin e procedurave, si dhe lehtësimin e klimës së të zbrit biznes.

Dëshiroj të risjell në vëmendjen tuaj faktin e kjo qeveri mbetet e angazhuar për vazhdimin e konsolidimit fiskal. Në këtë kuadër, jemi duke balancuar shpenzimet e domosdoshme për investimet publike, financimin e paketës së solidaritetit, si një instrument që tashmë e karakterizon këtë qeveri, në reflektim të drejtpërdrejt të vëmendjes ndaj qytetarëve, në financimin e reformave që mundësuan kthesën ekonomike, e cila po konsolidohet, duke mbajtur nga ana tjetër ritmin në rritjen e të ardhurave, uljen e vazhdueshme të borxhit publik, si dhe uljen e ngarkesës fiskale.

Pas stabilizimit të situatës financiare dhe shlyerjes së stokut të borxheve të prapambetura në vitin 2014 – 2015, që nga viti 2016 e në vijim, politikat dhe ndryshimet fiskale të dizenuara nga qeveria kanë synuar reduktimin gradual të barrës fiskale, nëpërmjet uljes së taksave.

Është një inventar i gjatë masash fiskale, të cilën e kemi bërë prezent edhe këtu në komision. Për interesin tuaj, mund t'i referoheni edhe prezantimit në *power point*, për të parë edhe historikun e uljes së taksave.

Paketa e thjeshtësimit të procedurave tatimor-doganore në vitin 2016 ishte një revolucion në klimën e të bërit biznes në vend, një shembull konkret i bashkëpunimit qeverisipërmarrje, gjë që sërish na dallon nga qeveritë e mëparshme, kur politikat diktoheshin nga zyrat e qeverisë dhe me asnjë konsultim me terrenin ekonomik.

Në ato procedura, dua t'ju rikujtoj se për herë të parë u vendos një marrëdhënie me sipërmarrjen, për kontrollin tatimor, ku sipërmarrja ka mundësi të vetëkorrektohet për një periudhë përtej 12 muajve, pa penalitet; ka të drejtë të negociojë kohën e auditit dhe kontrollit fiskal me tatimet; ka të drejtë që gjatë kontrollit, gjatë lajmërimit për kontroll të korrektohet me gjysmën e penalitetet. Detyrimisht, për kontrollin e thelluar duhet të lajmërohet 30 ditë përpara.

Në majin e 2018-ës, ne nisëm një proces të gjerë konsultimesh me të gjithë aktorët, në lidhje me paketën e qershorit, një pjesë e mirë e masave të së cilës hyn në fuqi më 1 janar të 2019-ës, por edhe për paketën e re të këtij viti, të cilën e prezantojmë sot, kemi filluar të konsultohemi me sipërmarrjen për paketën duke filluar që nga prilli i vitit 2018. Kemi bërë konsultime të vazhdueshme, individuale me shoqata publike, jopublike, me përfaqësues në këshillin tatimor, në Këshillin Ekonomik Kombëtar, pra konsultime të gjera dhe të thella për të arritur në këto konkluzione që kemi arritur. Ndryshimet e prezantuara në paketën fiskale të vitit 2019 synojnë uljen e mëtejshme të ngarkesës fiskale, incentivimin e sektorëve dhe përmirësimin e klimës së biznesit.

Qëllimi i paketës fiskale është ulja e barrës fiskale për qytetarët dhe biznesin, nëpërmjet uljes së normës tatimore të tatimit mbi të ardhurat, tatimit mbi fitimin dhe detyrimet e tjera, lehtësimit dhe të bërit biznes nëpërmjet thjeshtësimit të procedurave, reduktimit të kohës për çregjistrimin e biznesit, incentivimin e sektorëve dhe industrive të caktuara nëpërmjet lehtësimit dhe përjashtimeve tatimore, vendosjen e rregullave transparente në taksim duke parandaluar keqpërdorimin e ligjit dhe përfitimin e incentivave të padrejta fiskale, mbrojtjen e

interesave fiskale të vendit dhe të bazës së tatimit, duke parashikuar rregulla të reja të aplikueshme dhe në nivel ndërkombëtar.

Paketa e qershorit të vitit 2018 që vlen të ritheksohet fillon me uljen me 3 herë të normës së tatimit mbi fitimin nga 15% në 5% për sipërmarrjet me të ardhura 8-14 milionë lekë. Përfitojnë 11 mijë biznese ose 50% e bizneseve që taksoheshin me normën 15%, pas kësaj mase vetëm 9%, kjo është shumë e rëndësishme që ta theksojmë dhe ta ritheksojmë të gjithë bashkë, vetëm 9% ose 10 mijë e numrit total të tatimpaguesve taten me normën 15%, ndërkohë që 65% e tyre ose 71 mijë subjekte do të paguajnë tatimin zero. 65% e sipërmarrjes shqiptare e ka tatim-fitimin zero. 26% ose 28 mijë subjekte e kanë tatimin vetëm 5%, që do të thotë 91% e sipërmarrjes shqiptare sot e ka tatim-fitimin zero ose 5%. Diferencë shumë e madhe nga ajo që ka qenë 10 %-shi i padrejtë, varfërues në favor të 1% të sipërmarrjes dhe në disfavor, në ngarkesë të sipërmarrjes së vogël, të asaj të mesme dhe të të gjithë të punësuarve me paga me nivel mesatar dhe të ulët. Pra, një masë 10%-shi ka qenë një masë kundër 99% të punësuarve dhe sipërmarrjeve, incentivimin e fermerëve të inkorporuar në shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor duke ulur me 3 herë normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15 deri në 5%. Përfitojnë mbi 50 shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor të regjistruar ndërkohë që një masë e tillë do të nxisë kooperimin dhe krijimin e entiteteve të reja.

Më lejoni të bëj një kërcim nga sot në dje për t'ju rikujtuar që bujqësia do të jetë në vitin 2019 një nga sektorët më të financuar dhe të mbështetur, qoftë me fonde, qoftë me strukturë fiskale dhe ekonomike. Dje thamë se mbështetja me fonde është e madhe dhe numëruam 2,6 miliardë lekë që është mbështetja e drejtpërdrejtë e buxhetit për fermerët, 1 plus 3 miliardë, pra 4 miliardë është buxhet plus IPRD dhe pastaj kemi fondin e garancisë, i cili, nëse punohet mirë nga institucionet që drejtojnë sektorin, ka mundësi të injektojmë në bujqësi mbi 100 milionë dollarë vetëm investime të drejtpërdrejta ose mbështetje për fermerin.

Sot dua t'ju kujtoj se, kur iu referuam problematikës së bujqësisë, thamë që është fragmentimi, mungesa e ekonomisë së shkallës nëpërmjet instrumenteve fiskale që unë po përmend sot këtu, të cilat janë incentivimi i SHBB-ve, shoqërive të bashkëpunimit bujqësor, kemi mundësi të korrektojmë atë defekt në strukturën ekonomike të bujqësisë, por, sigurisht, që është sfidë e institucioneve tona që ta orientojnë zhvillimin në bujqësi në drejtim të ekonomisë së shkallës.

Instrumentet fiskale janë tashmë aty, në shërbim të kësaj politike që unë iu referova:

Incentivimi i fermerëve të inkomoruar në SHBB-të, duke hequr edhe prapin e qarkullimit prej 5 milionë lekësh për përfitimin e rimbursimit. Ky është një debat i vështirë, por një instrument incentivues me të njëjtën logjikë që folën më lart.

Incentivimi i bizneseve që janë të licencuara dhe operojnë në fushën e agroturizmit, duke reduktuar normën e tatimit mbi fitimin korporativ nga 15 në 5%, duke reduktuar normën e fitimit mbi vlerën e shtuar nga 20 në 6% për shërbimet ofrojnë në fermë akomodim dhe ushqim duke i përjashtuar subjektet e agrobiznesit nga taksa e ndikimit në infrastrukturë për ndërtimet me destinacion agroturizmin dhe duke u dhënë në këtë mënyrë të njëjtat incentiva stimuluese sikurse ato të turizmit me pesë yje, siç i kemi referuar gati një vit më parë.

Përjashtimi nga TVSH-ja për investimet në energjinë diellore me qëllim reduktimin e kostove dhe nxitjen e tyre. Vazhdimi i paketës fiskale nëntor 2018, pra sot, tatimi mbi dividendin ulët nga 15 në 8%. Përfitojnë mbi 15 mijë kompani ose rreth 50 mijë individë investitorë të kapitalit.

Parashikohet stimul për gjithë fitimet e akumuluar, të kapitalizuara nga vitet e kaluara duke zbatuar edhe ato për shpërndarje me normë tatimore 8% nëse tatimi paguhet brenda një afati të caktuar me ligj, që mendohet të jetë gjysma e parë e 2019-ës.

Ulja e kufirit të taksimit të pagës me 23%, pra janë 15400 të punësuar me pagë mbi 130 mijë lekë në muaj që do të përfitojnë në total 25,8 milionë lekë çdo muaj ose 310 milionë lekë në vit.

Tani dua që të kujtojmë se nëpërmjet kancelimit, çmontimit të taksës së sheshtë, armike e të gjithë të punësuarve, sidomos atyre me pagë më të ulët, ne vendosëm taksën progresive, ku sot përfitohen në përlogaritje të punësimit total dhe të fondit total të pagës në Republikën e Shqipërisë 120 milionë dollarë, të cilat dikur shkonin në buxhetin e shtetit (mos harroni se po bëjmë edhe konsolidim fiskal, po ulim edhe borxhin), sot shkojnë në xhepat e qytetarëve. 120 milionë dollarë, shtohet edhe 3 milionë dollarë të tjera, 123 milionë. Mos harroni se kemi duke ulur borxhin publik, pra kemi duke shëndoshur financat publike, pra po ndodhin dy procese në të njëjtën kohë: lehtësimi i barrës dhe ulja e borxhit. Në qendër qëndron përgjegjëshmëria e kësaj qeverie.

Për sa i përket sipërmarrjes, kemi ulje me 2/3-at e taksës së ambalazheve plastike dhe me 1/2-at të ambalazheve të qelqit, që do të thotë ulje kostojë prodhimi për prodhuesit vendas në industrinë ushqimore; përjashtim nga TVSH-ja i lëndëve të para të industrisë së prodhimeve

farmaceutike, duke e vendosur në kushte konkurrence të njëjta me medikamentet e importuara, të cilat janë të përjashtuara; përjashtim nga TVSH-ja i importit të makinerive bujqësore, me qëllim lehtësimin e mundësive për fermerët dhe nxitjen e tregut të brendshëm të importimit dhe tregtimit të tyre; normë të reduktuar me 10 % TVSH në importimin e autobusëve elektrikë, të destinuar për transportin publik, si një masë që do synojë kufizimin e përdorimit të mjeteve ndotëse të ambientit; përjashtim nga TVSH-ja i nënkontraktorëve në industrinë fason për eksport, me qëllim lehtësimin e kostove të eksportuesve, lehtësimin e skemës së rimbursimit të TVSH-së, lehtësimin e situatës së *cash flow*, pra të qarkullimit të likuiditeteve, për nënkontraktorët, të cilët paguheshin vetëm kur eksportuesi rimbursonte TVSH-në; procedura më të thjeshta dhe transparente regjistrimi dhe çregjistrimi të biznesit, duke reduktuar kohën dhe burokracinë.

Për sa i takon aspektit të financave publike, paketa parashikon masa dhe ndryshime, të cilat synojnë të mbrojnë bazën e tatimit në Shqipëri dhe kufizimin e keqpërdorimit të tarifave të ulëta dhe taksave zero nga biznesi i madh i regjistruar si i vogël me disa NIPT-e, pra rregulla të forta; individë tradicionalisht me kontrata punësimi dhe paga në nivele të larta, që fiktivisht shndërrohen në biznes të vogël për të përfituar taksën zero.

Parashikohen masa të tilla, që, për të ardhurat dhe fitimet që lidhen me pasuritë e vendit, tatimi të paguhet në Shqipëri, si rasti i Bankers. Kur Bankers u shit jashtë Shqipërisë, Shqipëria nuk përfitoi asgjë nga shitja. Nuk arriti ta tatonte për shkak të sistemim fiskal dhe të rregullave, që akoma nuk i ka adoptuar dhe po i adopton me këtë paketë të avancuar nga OECD-ja.

Mbrohen të drejtat fiskale të vendit, duke detyruar pagimin e tatimit mbi fitimet kapitale të jorezidentëve (shembulli që ju solla me Bankers, që shet aksionet jashtë Shqipërisë dhe Republika e Shqipërisë nuk përfiton asnjë cent).

Implementohen parimet e gjithëpranuara në kuadër ndërkombëtar, në lidhje me klauzolën antiabuzim me taksat dhe planifikim agresiv tatimor, duke shmangur tatimet.

Përmbajtja e paketës fiskale 2019.

Ligji “Për tatimin mbi të ardhurat”.

1. Ulje e normës së tatimit mbi dividendin (pra, po i kaloj edhe si ligje të veçanta) nga 15 % në 8 %.

2. Rritje e kufirit të pagës, që tatohet me 23 % nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë.

3. Dispozitë taksimi për fitimet kapitale të jorezidentëve, për shitjen e kuotave të kompanive apo aktiveve që ndodhen në Shqipëri.

4. Dispozitë saktësuese për tatimin që mbahet në burim për shërbimet e jorezidentëve.

5. Kufizim sasior në lidhje me shpenzimet për dieta, që ishte një lloj shmangieje i bazës tatimore, e tatimit mbi të ardhurat personale.

Ligji “Për taksat nacionale”.

1. Kalimi nga taksimi i ambalazheve plastike, tek taksimi i materialeve plastike. Ulje e tarifës së taksës me 2/3 dhe ulje me 50 % e tarifës së taksës për ambalazhet e qelqit.

2. Rritje e rentës minerare për eksportin e kromit nga 6% në 9%, që e përmenda edhe dje.

Ligji “Për Tatimin mbi Vlerën e Shtuar”.

1. Përfshirja nga importi i lëndëve të para për fabrikat e prodhimit farmaceutik.

2. Përfshirja nga TVSH-ja i furnizimit me shërbim nga nënkontraktorët për kontraktorët e industrisë fason.

3. Përfshirja nga TVSH-ja i importit të makinerive bujqësore sipas listës së miratuar me Vendim të Këshillit të Ministrave, nga çdo importues.

4. Normë e reduktuar TVSH-je 10 % për importin e autobusave elektrikë të transportit publik

5. Normë e reduktuar 6 % për shërbimin e reklamave nga televizionet.

Ligji “Për akcizat”. Vendosija e akcizës 1 lekë për kilogram për zhavorret vituminoze, që përdoren si lëndë djegëse alternative,

Heqja e akcizës për fishekzjarret, llampat, pilat, bateritë e sugjeruar nga Fondi Monetar.

Rritja e akcizës së duhanit të përpunuar dhe zëvendësuesit e tij, duhanet me ngrohje dhe purot.

Ligji “Për procedurat tatimore”. Dispozitë antishmangie nga taksat në përputhje me direktivën e Bashkimit Europian.

Dispozitë antishmangie në lidhje me regjistrimin e më shumë se një biznesi nga personat fizikë tregtarë, është evazioni që bëjnë individë të ndryshëm, duke krijuar entitete të ndryshme, të cilat i kthejnë në pasivë dhe i lënë të ngarkuar me borxhe ndaj tatimeve dhe krijojnë një person fizik tjetër. Kjo dispozitë antishmangie do ta reduktojë deri në eliminim këtë fenomen gangrenizues për bazën tatimore, si dhe lehtësimi i procedurave të çregjistrimit të biznesit.

Ligji “Për taksat vendore”. Janë rregullimet procedurale që synojnë saktësimin e aplikimit të ligjit nga njësitet e pushtetit vendor, duke iu referuar taksës së infrastrukturës që ka të bëjë: kur ndërtojnë vetë, kur ndërtojnë me shoqëri dhe kur ndërtojnë banesa apo objekte komerciale.

Ligji “Për tarifat”. Rishikimi i disa tarifave dhe unifikimin e tyre për mallra të njëjtë.

Kjo është rezymeja në parim e të gjithë paketës fiskale për vitin 2019.

Faleminderit për vëmendjen!

Erion Braçe – Faleminderit!

Në emër të relatorëve, fjalën e ka zonja Gjylameti,.

Blerina Gjylameti – Faleminderit, kryetar!

Komisioni për Ekonominë dhe Financat, në cilësinë e komisionit përgjegjës dhe në zbatim të neneve 78 dhe 83 të Rregullores së Kuvendit, është duke shqyrtuar projektligjin “Për buxhetin e viti 2019” dhe projektligjet financiare, të cilat kanë lidhje drejtpërdrejt me të.

Paketa fiskale e vitit 2019 është paraqitur nga Këshilli i Ministrave sipas përcaktimeve të neneve 81 dhe 82 të Kushtetutës dhe shoqërohet me relacionin përkatës sipas nenit 68 të Rregullores së Kuvendit.

Vlen për t’u theksuar se buxheti i shtetit dhe projektligjet financiare që e shoqërojnë atë janë paraqitur në Kuvend në datën 29 tetor, praktikë e ndjekur në 5 vjetët e fundit, e cila fuqizon rolin e Kuvendit në procesin e vlerësimit, shqyrtimit dhe miratimit të buxhetit. Paketa e re fiskale, që shoqëron projektbuxhetin e vitit 2019, tregon edhe një herë angazhimin konkret që ka ndërmarrë qeveria shqiptare në drejtim të zbatimit të një programi ambicioz dhe reformash, të cilat kanë si qëllim sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike, vazhdimin e luftës kundër informalitetit, zhvillimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit të administratës fiskale për të rritur eficiencën e punës, zhvillimin e mëtejshëm të kuadrit ligjor, forcimin e burimeve njerëzore të administratës, rritjen e punëzënies dhe përmirësimin e mirëqenies së qytetarëve shqiptarë.

Projektligjet financiare paraqesin në mënyrë të qartë dhe të detajuar politikat tatimore që do të ndiqen gjatë vitit 2019, si në drejtim të zgjerimit të të ardhurave tatimore, po ashtu edhe për nxitjen e përmirësimit të klimës së biznesit, duke mos anashkaluar edhe analizimin e risqeve dhe problematikave që mund të hasen në zbatimet e tyre.

Projektbuxheti i vitit 2019 do të ketë më shumë burime në dispozicion si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të bazohen në uljen e informalitetit, duke synuar në të njëjtën kohë nxitjen e investimeve private strategjike në sektorët prioritarë. Konkretisht, paketa fiskale përmban 6 nisma ligjore, të cilat vijnë si më poshtë:

E para, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 61/2012 “Për akcizat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar”.

E dyta, “Për një ndryshim në ligjin nr. 99 81, datë 08.09.2008 “Për miratimin e niveleve të tarifës doganore”, të ndryshuar”.

E treta, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, e ndryshuar”.

E katërta, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 92/2014 “Për tatimin mbi vlerën e shtuar”, të ndryshuar”.

E pesta, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 9975, datë 28.07.2008 “Për taksat kombëtare”, të ndryshuar”, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, të ndryshuar”, si dhe “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 99, datë 19.05. 2008 “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Megjithatë, vlen të theksohet se paketa e plotë fiskale për vitin 2019, e hartuar nga Ministria e Financave, nuk kufizohet vetëm në këto projektligje, por përfshin edhe reforma të qenësishme të kuadrit rregullator fiskal, siç ishin ndryshimet e miratuara në korrik të këtij viti në ligjin “Për tatimin mbi të ardhurat”, ligjin “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë” dhe ligjin “Për sistemin e taksave vendore”.

Në paketën fiskale të korrikut u miratuan lehtësira fiskale të qenësishme për zhvillimin e sektorëve kyç të ekonomisë shqiptare, siç janë bujqësia dhe turizmi, të cilët, në vizionin e qeverisë, shihen si sektorë që do të garantojnë zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, duke siguruar punësim, nxitje të ndërmarrjeve të vogla e të mëdha, më shumë të ardhura dhe më shumë mirëqenie për qytetarët shqiptarë. Për të rikujtuar, më 1 janar hyjnë në fuqi dispozitat që parashikojnë:

1. Uljen e tatim fitimit nga 15% në 5% për tatimpaguesit me qarkullim nga 8 milionë deri në 14 milion lekë, që janë rreth 10,850 biznese ose gjysma e bizneseve që paguajnë tatim fitimin.

2. Uljen e tatim fitimit nga 15% në 5% për shoqëritë e bashkëpunimit bujqësor, të cilat operojnë sipas ligjit nr. 38/2012. Ky ndryshim vjen në vazhdimësi të ndryshimeve të tjera, që kanë përfituar gjatë këtij viti këto shoqëri, siç është dhe rimbursimi i TVSH-së në masën 20% apo subvencionimi, investimi në kullim dhe ujitje dhe asistenca financiare e BE-së e dhënë nëpërmjet IPARD-it.

3. Zhvillimin e sektorëve të veçantë të turizmit, siç është dhe agroturizmi, për të cilin është propozuar aplikimi i një norme të reduktuar të tatim fitimit në masën 5% për një periudhë 10-vjeçare. Ndryshimin e sipërpërmendur do ta përfitojnë të gjithë ato struktura akomoduese, të cilat do të përfitojnë statusin “subjekt i certifikuar agroturizmi” nga 1 janari i vitit 2019 deri më 31 dhjetor të vitit 2021.

4. Përfshirja nga taksa e ndikimit në infrastrukturë dhe e investimeve në infrastrukturë për strukturat akomoduese të certifikuar si agroturizmi.

5. Aplikimi i shkallës së reduktuar të tatimit mbi vlerën e shtuar 6% për strukturat, të cilat zhvillojnë veprimtari pritëse të certifikuar si “agroturizëm”, për furnizimin e shërbimit të akomodimit dhe restorantit.

Përmbajtja e paketës fiskale të fundvitit

Hartimi i paketës fiskale 2019 është bërë në drejtim të mbështetjes së reformave të qeverisë për zbatimin e programit politik të saj për këtë mandat të dytë dhe objektivave konkretë që ka për vitin 2019, në mbështetje të prodhimit vendas, si dhe në funksion të lehtësimit të procedurave për biznesin. Për këtë arsye në projektbuxhetin e vitit 2019 janë planifikuar më shumë burime si rezultat i politikave fiskale, të cilat do të vazhdojnë të bazohen në taksimin e ndershëm harmonizuar me përmirësimin e administrimit fiskal dhe minimizimin e informalitetit në ekonomi. Në mënyrë të detajuar disa nga masat konkrete të propozuara janë:

Për prodhimin vendas

1. Përfshirja në kategorinë e veprimtarive me interes të përgjithshëm, të përjashtuara nga TVSH-ja edhe furnizimi i makinave bujqësore, i cili deri më tani ishte furnizim i përjashtuar vetëm në import. Përfshirja do të funksionojë sipas së njëjtës listë makinash bujqësore, të miratuar me vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 953/2014 dhe do të lehtësojë kostot e investimit të sektorit bujqësor.

2. Përrjashtimi nga TVSH-ja e furnizimit të shërbimeve të përrpunimit të mallrave joshqiptare të destinuara për t'u rieksportuar, të kryera nga nënkontraktorët, për operacione nën regjimin e përrpunimit aktiv, në vazhdën e incentivave të dhëna për të fuqizuar industrinë fasone.

3. Përrjashtimi i TVSH-së së paguar në import për lëndët e para që përdoren për prodhimin e barnave, me përrjashtim të lëndëve të para me përdorim të dyfishtë, me qëllim lehtësimin dhe zhvillimin e industrisë vendase të prodhimit të barnave, nëpërmjet uljes së kostove të prodhimit.

4. Heqja e akcizës së rërës bituminoze dhe vendosja e akcizës për zhavorrin bituminoz, i cili po përdoret gjerësisht si lëndë djegëse zëvendësuese në industrinë e prodhimit të tullave e të çimentos dhe që sipas nomenklaturës së kombinuar të mallrave klasifikohet në kapitullin 27 "Lëndët djegëse minerale, vajrat minerale dhe produktet e distilimit të tyre, substancat bituminoze, dyllet minerale".

5. Rritjen e përrqindjes së rentës minerare nga 6-9 % për mineralet e kromit për eksport, pjesë e grupit të parë, për mineralet metalike të shtojcës nr.2 të ligjit, si dhe rishikimin e përrqindjes së rentës minerare për përrmbajtjen e mineralit metalor në produktin minerar, duke ulur nga 1/2 në 1/3 masën e normës së rentës, duke u mbështetur në nevojën e ndërmarrjes për politika që simulojnë përrpunimin e mineralit në vend dhe rritjen e vlerës së tij për eksport, si edhe dekurajimin e eksporteve të mineralit krom të papërrpunuar; rishikimin e dispozitave që lidhen me taksën e ambalazheve të plastikës dhe të qelqit, duke bërë një kategorizim, si të produktit, ashtu dhe të nivelit të taksës për të reflektuar problematikën e evidentuar nga strukturat e Bashkimit European që lidhen me diferencimin e taksës në import në prodhimin vendas, si dhe për të përrmbushur kërkesat e industrisë vendase të prodhimit ushqimor për kufizimin e konkurrencës së pandershme dhe përrjashtimin nga pagesa të taksës së karbonit vetëm për sasitë e benzinës dhe gazoilin që ekspertohen, duke unifikuar kështu edhe përrjashtimin e këtyre produkteve nga taksa e qarkullimit të bërë në vitin 2016.

Sa i përrket pushtetit vendor, në kuadër të zbatimit të reformës administrative territoriale ndër masat më të rëndësishme, të cilat i miratuar vitin e kaluar, ishte edhe reforma për taksën e ndërtesave me ngritjen e strukturave të posaçme dhe krijimin e kadastrës fiskale. Me qëllim zbatimin më të saktë nga ana e njësive të qeverisjes vendore jo vetëm të dispozitave që lidhen me taksën e pasurisë së ndërtesë, por edhe të dispozitave të tjera të ligjit për sistemin e taksave

vendore janë propozuar ndryshime për rishikimin e terminologjisë, si edhe saktësimin e paqartësive që mund të lindin, sidomos për rastet e përjashtimit nga pagimi i taksave vendore.

Sa i përket biznesit do të bëhet lehtësimi i barrës fiskale për 20 mijë biznese ose përmbi 50 mijë investitorë të kapitalit nga ulja e normës së tatimit mbi devidentin nga 15% në 8 %. Kjo masë vlerësohet të ketë impakt pozitiv në të ardhurat buxhetore të vitit 2019 me 4,5 miliardë lekë, si rrjedhojë edhe e përcaktimit të bërë në dispozitat kalimtare për aplikimin e normës 8%, në aplikimet e pashpërndara, por të akumuluar ose të kapitalizuar të viteve të kaluara, vendosjes së detyrimit për personin juridik për të paguar tatimin mbi fitimin në rastin e ndryshimit më shumë se 20% në vlerë të pronësisë direkte dhe ose indirekte të kapitalit aksionar, kuaotave ose të drejtave të votimit, njoftimin e administratës tatimore brenda 45 ditëve për detajimin e ndryshimit, si edhe përjashtimin nga pagimi i tatimit për çdo ndryshim, ndërsa sa u përket individëve uljen e ngarkesës fiskale për të punësuarit duke rritur fashën e të ardhurave që tatohen me normën 13% nga 130 mijë lekë në 150 mijë lekë në muaj. Nëpërmjet kësaj mase synohet të ulet barra tatimore për rreth 15 mijë e 400 të punësuar jo vetëm në sektorin publik, por edhe në sektorin privat. Kjo ulje tatimi shoqërohet edhe me disa ndërhyrje në ligjin e procedurave tatimore, të cilat i japin të drejtë tatimeve të rikategorizohen tatim- paguesi kur ai paraqet një fytyrë të rremë të të ardhurave me qëllim limitimin e abuzimeve me shmangien tatimore në pagat e larta, mosnjohjen si shpenzimet të zbritshme në përcaktimin e fitimit të tatueshëm të shpenzimeve për dieta që tejkalojnë 50% të fondit të pagave bruto vjetore, kjo masë në kuadër të angazhimeve për minimizimin e shmangieve dhe ruajtjen e bazës së tatueshme, përfshirjen në persona që i nënshtrohen tatimit mbi fitimin të personave jorezidentë, përfitime të realizuara nga shitja e aksioneve ose interesave të ngjashme vlera e të cilave buron nga pasuri të paluajtshme në Republikën e Shqipërisë. Këto individë do të detyrohen të plotësojnë deklaratën e të ardhurave të tatueshme brenda datës 31 mars të vitit pasardhës.

Propozime të tjera për t'u përmendur janë edhe stimulimi i politikave në transport në funksion të mbrojtjes së ambientit nëpërmjet reduktimi të shkallës së TVSh-së nga 20% në 10%, për furnizimin e mjeteve të transportit publik të udhëtarëve me autobus me 10 vende ose më shumë, të cilët duhet të jenë të pajisur me motor elektrik, zgjerimin e bazës së tatueshme në vend nëpërmjet përfshirjes së të ardhurave nga të drejtat për shfrytëzimin e pasurive minerare hidrokarbure ose burimeve natyrore si aksioneve dhe interesave të ngjashme me to. Nxitjen dhe lehtësimin e investimeve në kuadër të dixhitalizimit të mediave audiovizive nëpërmjet aplikimit

të shkallës së reduktuar të TVSH-së në masën 6%, për furnizimin e shërbimit të reklamave nga këto medie. Ndryshimin e nivelit të akcizës për produktin e duhanit të grirë, purot, cigarilot dhe cigaret me zëvendësues duhani, duke e çuar nivelin e taksimit nga 4400 lekë për kilogram, që është aktualisht në masën 6000 lekë për kilogram, me qëllim barazimin e taksimit të produkteve të kësaj kategorie me kategorinë cigare që përmbajnë duhan, pra në masë të njëjtë me kalendarin e taksimit të cigareve më 1 janar 2019.

Gjithashtu, ndryshimi mundëson unifikimin e nivelit të taksimit me direktivën e BE-së 2011/64, e cila përcakton nivelin minimal të akcizës, të paktën 60 euro për kilogram. Shtimin e një produkti të ri duhan me ngrohje, në listën e mallrave të akcizës me akcizë 6 mijë lekë për kilogram, për shkak se tashmë në tregun shqiptar do të tregohet edhe ky produkt, i cili është si cigarja, por konsumohet nëpërmjet një aparati të prodhuar posaçërisht dhe niveli i akcizës për të propozohet në masën 6 mijë lekë për kilogram.

Heqja nga lista e mallrave të akcizës, si: fishekzjarrë, llamba, pila, bateri, për të cilat deri më sot aplikohet akcizë respektivisht në masën 200 lekë për kilogram dhe 100 lekë copa. Kjo masë justifikohet me faktin se, bazuar në direktivë, këto mallra nuk konsiderohen produkt akcize. Saktësimin e metodës së përlllogaritjes së akcizës për produktin “nikotinë lëng” për mbushjen e cigareve elektronike si saktësime e ndryshime për shkelje në fushën e akcizës dhe sanksionet. Unifikimin e tarifës doganore në masën 10%, për të gjitha kodet 8-shifrore të kreut 8418 “Njësi frigoriferike” të nomenklaturës të kombinuar të mallrave me qëllim krijimin e një konkurrence të drejtë e të ndershme për të gjithë importuesit që operojnë në këtë veprimtari.

Gjithashtu, plani i qeverisë për realizimin e reformave të rëndësishme fiskale do të shoqërohet edhe me vazhdimin e reformave në drejtim të përmirësimit të punës së administratës tatimore dhe doganore nëpërmjet thjeshtimit të vazhdueshëm të procedurave, luftës ndaj korrupsionit dhe parandalimit të evazionit fiskal të përfshira në ndryshimet e propozuara në ligjin për procedurat tatimore, i cili në mënyrë specifike synon:

- përmirësimin e rregullave të regjistrimit dhe të pajisjes me NIPT NUIS të tatimpaguesve me qëllim deklarimin e saktë të të ardhurave të realizuara dhe shmangien e evazionit;

- lehtësimin e procedurave tatimore për tatimpaguesit përmes përdorimit të gjerë të komunikimit elektronik, si dhe thjeshtimit dhe qartësimit të procedurave të njoftimit për pagesën e detyrimeve tatimore të pagesës dhe radhës së pagesave;

- rregullimin e disa mangësive të konstatuara në praktikë, që lënë hapësirë për shmangie të deklaramit dhe pagesës së detyrimeve reale nga tatimpaguesit.

- Përdorimin e mënyrave alternative të vlerësimit tatimor për rastet kur tatimpaguesit kryejnë veprime apo transaksione, të cilat synojnë përfitimin e një avantazhi tatimor në kundërshtim me legjislacionin tatimor dhe rezultojnë fiktive mbi prova dhe fakte.

Së fundi, ndryshime propozohen edhe në trajtimin e kundërvajtjeve administrative, duke parashikuar, ndër të tjera, ulje të penalteteve për rastet kur tatimpaguesit pranojnë vlerësimin tatimor dhe paguajnë detyrimin. Megjithatë, duhet të kihet parasysh nga qeveria kërkesa e vazhdueshme për forcimin e institucioneve fiskale dhe vlerësimin e rreziqeve fiskale të nevojshme për të trajtuar borxhet, duke përfshirë rimbursimin e TVSH-së dhe projektet e papaguara të investimeve. Autoritetet tatimore duhet të përmirësojnë procesin e rimbursimit të TVSH-së, të forcojnë kontrollin dhe të regjistrojnë të gjitha detyrimet e papaguara.

Në përfundim të fjalës sime, dua të vlerësoj faktin se të 7-ta projektligjet fiskale janë hartuar në shërbim të interesit publik dhe në përputhje të plotë me politikat e shtetit për grumbullimin e të ardhurave të ligjshme, pa harruar edhe krijimin e lehtësive për biznesin prodhues, uljen e barrës fiskale, stimulimin e prodhimit vendas, shtimin e numrit të punonjësve në sektorin vendas, minimizimin e evazionit fiskal dhe sigurimin e një rritjeje të qëndrueshme ekonomike.

Kam disa sugjerime në parim.

Së pari, sugjerojmë disa ndryshime për sa i përket mbrojtjes së pagave më të ulëta, duke marrë parasysh faktin që në këto vite, tashmë në vitin e 5-të, kemi pasur herë pas here ngritje të këtyre pagave. Në këtë mënyrë, ato hyjnë në fasha të cilat paguajnë tatim mbi të ardhurat.

Së dyti, duke marrë parasysh faktin e mbështetjes që po japim për bujqësinë, që përben edhe një nga sektorët kryesorë të ekonomisë, sugjerojmë të shikojmë zbatimin konkret të angazhimeve të ndërmarra ndër vite, por që nuk kanë qenë asnjëherë reale, duke ulur TVSH-në e inputeve bujqësore.

Së treti, sugjerojmë gjithashtu, sikundër po aplikojmë rritjen e rentës minerare, me qëllim shtimin e vlerës së tyre, duke pasur parasysh që burimet janë të funde, që kjo politikë të aplikohet jo vetëm për disa prej produkteve, por në të gjithë industrinë nxjerrëse.

Së fundi, një sugjerim tjetër ka të bëjë me uljen e tatimit mbi dividendin. Duke marrë parasysh faktin që ka një ulje të tatimit mbi dividendin nga 15% në 8%, sugjerojmë të rishikohet

edhe një herë kjo politikë, me qëllim që të kemi deri në zerim të tatimit mbi dividendin për të gjithë dividendin e riinvestuar, me qëllim që të kemi një rritje dhe zgjerim të aktivitetit. Pra, të mos kemi ulje vetëm për dividendin e pashpërndarë, por për riinvestimin.

Duke ju falënderuar për vëmendjen, kur të fillojmë të diskutojmë projektligjet e paketës fiskale dhe kur t'i shqyrtojmë nen për nen, do të vazhdojmë me saktësime apo me sugjerime të tjera.

Ju faleminderit!

Erion Braçe – Ju faleminderit, zonja Gjylameti!

A ka pyetje?

Zonja Kushi, urdhëroni!

Evis Kushi – Faleminderit!

Duke falënderuar edhe ministrin për prezantimin e paketës fiskale, po kaloj direkt te pyetja. A janë konsultuar grupet e interesit, shoqatat e biznesit, dhomat e tregtisë në lidhje me të gjitha ligjet e paketës fiskale? Sa janë marrë mendimet e tyre? A ka pasur, apo jo dakordësi? A ka pika ku ata ende nuk janë dakord dhe cilat janë argumentet tuaja?

Faleminderit!

Erion Braçe – Urdhëroni!

Arben Ahmetaj – Është bërë një konsultim shumë i gjatë, duke filluar që nga muaji prill i këtij vitit me biznesin e vogël. Për hir të së vërtetës, logjika e rritjes së pragut nga 8 milionë në 14 milionë ishte logjike e përfaqësuesve të sipërmarrjes së vogël. Kërkesa për të ulur dividendin ishte në vazhdimësi kërkesë e sipërmarrjes në tërësi. Kuptohet që ne jemi një vend në konsolidim të domosdoshëm fiskal dhe u kërkua 5 %, por 8% u kalkua në një balancë midis tatimit 23% të të ardhurave personale, niveli më i lartë, me 15%+8% të entiteteve, pra të sipërmarrjes. Në përgjithësi të gjithë kanë rënë dakord me sipërmarrjen, patjetër ka elemente që nuk kemi rënë dakord, të cilat, në këndvështrimin e qeverisë, janë në interesin publik që të jenë në ato nivele. Pra, ka kërkesa të çuditshme të uljes së tatimit deri në 7% të TVSH-së së ushqimeve në 5 %. Domethënë, unë e mirëkuptoj dhe e kuptoj logjikën e kujt do që kërkon ulje taksash, ky është një nga vendet me ngarkesën fiskale më të ulët. Pra, në grupin e vendeve me ngarkesën fiskale më të ulët në Europë hyn edhe Shqipëria, ndërkohë është një nga vendet që ka nevojë për konsolidimin fiskal të uljes së borxhit më të madh se çdo vend tjetër në Europë. Pra,

ka një kundërshtim, por janë konsultuar në detaje dhe në shumicën e kërkesave kemi rënë dakord.

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Urdhëroni, zonja Dhima!

Antoneta Dhima – Faleminderit, zoti kryetar!

Faleminderit, zoti Ministër, për prezantimin!

Kam dy pyetje: së pari, a mendoni se ulja e dividendit nga 15% në 8% do t'i nxisë bizneset që fitimet e tyre t'i investojnë në këto biznese ose të krijojnë biznese të tjera?

Së dyti, a ka mundësi që, nga ana juaj, të rishikohet mundësia e rritjes së rentës minerare, e cila kalon në llogari të pushtetit vendor nga 5%, ku përqindjen mund ta caktoni ju sa mund të shkojë? Njëkohësisht, të rritet kufiri i pagesës nga ana e kompanive, të cilat operojnë në këtë fushë...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Të shikohet mundësia e kompanive, të cilat derdhin sot 10%, pra të rritet kjo përqindje në 15% dhe këto të përdoren nga ana e bashkive për investime sociale pranë komunitetit në të cilin operojnë këto.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Ka qenë 25% është bërë 5% dhe normalisht zona, që mbuloj është një zonë ku operon kompania “Albpetrol” dhe kompania “Bankers”, është një zonë që nuk ka investime për komunitetin.

Faleminderit!

Arben Ahmetaj – Pyetja e parë ka të bëjë me uljen e dividendit, po ta shikoni me kujdes ligjin specifik të tatimit mbi të ardhurat, realizon edhe një kalim retrospektiv të tatimit mbi dividendin me 8%. Për ato fitimet e kapitalizuara, por të investuara, nuk do të ishte e mundur edhe për shkak të trupëzimit të tyre në asete të lëvizshme ose të palëvizshme. Nuk po i hyj atij shpjegimi në detaje, por do ta diskutojmë kur të kalojmë ligjin specifik. Vetëm 11% e sipërmarrjes shpërndante dividend, ndërkohë ne kemi vënë re se është akumuluar fitim i pashpërndarë ndër vite i konsiderueshëm. Më pas kemi marrë parasysh edhe një balancim me rajonin.

Përmendët rentën minerare, praktikisht dua t'ju kujtoj se transfertat e pakushtëzuar e përgjithshme e pushtetit vendor është rritur në mënyrë të konsiderueshme dhe është vënë në

ligjin e financave vendore 1% e prodhimit të brendshëm bruto. Kështu që, siç e shikoni nga 2,3% të prodhimit të brendshëm bruto, që ka qenë pushteti vendor, në mbështetje ka shkuar në 2,9% e prodhimit të brendshëm bruto. Domethënë, instrumentet duhen parë në tërësi, pra instrumentet në mbështetje të pushtetit vendor nuk mund të shikohen të fragmentuara, renta aty dhe transferta e pakushtëzuar këtu, apo shpërndarja e taksave dhe tatimeve, të gjitha shikohen dhe analizohen bashkë. Rezultati i analizës tregon që ne i kemi dhënë shumë mbështetje pushtetit vendor sesa disa vite më parë.

Faleminderit!

Erion Braçe – A ka pyetje të tjera?

Po, zoti Bushati!

Ervin Bushati – Faleminderit!

Në fakt, të gjitha ndërhyrjet më duken koherente dhe në konsistencë. Unë kam rezerva dhe dua që kur të diskutojmë, siç e thatë edhe ju...

Sot në teoritë më progresive, dividendi përpiqet të mbahet më i lartë se norma e tatimit pikërisht sepse ata që janë investitorët kryesorë shpeshherë, edhe për shkak të digjitalizimit të ekonomisë, pavarësisht se ku lëvizin dhe ku i vendosin selitë e tyre kryesore, në fund fare përgjegjës është përfituesi final, që është pronari. Pyetja ime është: a do të kemi disa skenarë, ku të diskutohet më në detaje sesi do të ishte në qoftë se kombinohen në një mënyrë tjetër, sepse edhe ne kemi qenë në një presion pozitiv nga profesionistë të lirë apo njerëz, të cilët thonë se edhe duke kontribuar në shoqëri, një pjesë intelektuale dhe opinionbërëse në shoqëri, norma e tatimit të rrogës shkon deri në nivelet më të larta, deri në 23%, që duket sikur i incentivon të kthehen në biznese të veçanta, ndërkohë që mund t'i shërbenin atij funksioni?

Kur të vijë kohë dua të di nëse do të kemi llogari të tilla për të parë disa skenarë sesi mund të kombinohen në mënyrën më të mirë. Sot, në botë, drejt kësaj po shkohet, që dividendi të jetë i lidhur direkt me personazhin, që është pronari, dhe me tatimin mbi tokën, që në shumë vende po rishikohet të rritet sa më shumë.

Faleminderit!

Erion Braçe – Para se të përgjigjet ministri, dua të shtoj diçka.

Zoti Bushati, unë e kuptoj shqetësimin e të gjithë opinionbërësve, që nuk dinë të bëjnë llogari, por norma efektive prej 23%, të cilës ju i referoheni, fillon të llogaritet për pagat mbi 4 milionë lekë. Nuk ka tatim 23% në këtë vend. Në këtë vend ka tatim 13 mijë lekë plus 23% të

çdo leku mbi 130 mijë lekë. Është krejt ndryshe nga ajo që thonë vazhdimisht këta opinionbërësit, të cilët nuk dinë të bëjnë llogari.

Arben Ahmetaj – Zoti Bushati, në vazhdim të asaj që tha zoti Braçe, së pari, më vjen keq, por nuk ka tatim 23%, ai është nominal dhe efektivisht shkon më pak.

Së dyti, nëse ju mendoni se ky tatim është i lartë, unë po ju them se vetëm një përqindje shumë e vogël e të punësuarve taksohen me këtë. Thënë kjo, 96,4% e të punësuarve taksohen më me pak sesa 10% dhe kjo është shumë e rëndësishme.

Së treti, për sa i përket dividendit, ju u referoheni intelektualëve sikur duhet të jenë të përjashtuar nga taksat dhe ata që janë biznesmenë të ngarkohen me taksa. Çdo individ në Republikën e Shqipërisë, që ka të ardhura, në një mënyrë ose tjetër duhet të paguajë taksa. Ka një klasë intelektualësh, që do ta diskutojmë në detaje, të cilët i kanë të ardhurat 2 milionë euro dhe nga logjika zero e personave fizikë kanë përfituar. A e dini që ka kompani, nuk dua t'i them me emër, sepse do të ishte thyerje e kodit, që janë persona fizikë, të painkorporuar, që kanë të ardhurat 2 milionë euro dhe nuk paguajnë asnjë lekë. Do ta korrigjojmë tani! Çfarë do të thotë kjo?! Merr 2 milionë euro të ardhura, të gjithë partnerët i ka të vegjël, kanë bërë shifting të bazës fiskale, nga të punësuar kanë dalë persona fizikë, kanë shmangur 23%-in dhe tani vijmë te dividendi, që është 15 dhe 8, shkon në nivelin e të ardhurave personale, aq më tepër që kemi parë fenomenin e fryrjes së fitimit të pashpërndarë.

Unë besoj se krijon një balancë, dhe këtu në këtë komision duhet të mbyllim ato çarje që ka sistemi, siç ju solla edhe shembullin. A e dini se ka 40 persona fizikë, të numëruar tani, që nuk paguajnë asnjë taksë? Pra, për shkak se kanë përfituar nga të qenit persona fizikë, paguajnë një shumë, pastaj për të ardhurat personale...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Si e paske të ardhurën personale 2 milionë euro dhe nuk paguake 23%?! Pse, ku jemi? Pra, janë të gjitha...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Më vjen keq që e bëjmë këtë debat bashkë, pasi ju e dini shumë mirë se këto janë të integruara. Pra, asnjë nga elementet që thamë nuk fragmentohet në analizë, qoftë të ardhurat personale të 23-shit; qoftë ajo që tha zoti Braçe, se norma efektive zbret nën 23; qoftë ajo që thashë unë, se as 3% s'e paguajnë normën 23%; qoftë këta intelektualët, të cilët, në favor të

punës së tyre, janë persona fizikë dhe nuk paguajnë të ardhurat personale të 23% aty ku duhet të paguajnë.

Po të shikoni llogaritë, që, për shkak të punës mua m'i sjellin Tatimet t'i shoh, është e padrejtë ndaj atij që paguan atje dhe paguan 23%. Për më tepër, unë e di edhe zhurmën, se tani në këtë vend... Kam dëgjuar një nga përfaqësuesit e biznesit, të cilit iu bë 8% në bazë të logjikës që kemi këtu të gjithë bashkë, nga 15% në 8%: "Ore, ç'është kjo 8%? Si ka mundësi? Pse nuk e bëni 4%?" Unë e kuptoj shumë mirë edhe natyrën njerëzore, edhe natyrën e sipërmarrjes, ata kërkojnë ulje taksash. Por edhe kur të taksojmë grupin e personave fizikë, të cilit iu referova, jam i bindur se do të kthehen në logjikën e parë: "Ore, si na taksoni"?!

Po të punësuarin atje pse e taksojmë? Pse një grup u dashka taksuar, ndërsa një grup fare i vogël nuk u dashka taksuar?!

Faleminderit!

Erion Braçe – Kur të diskutohet ligji nesër...

Ervin Bushati – Është keqkuptuar, se unë nuk jam as armiku, as populist.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Jo, më falni, edhe një herë...!

Ervin Bushati – Unë po them krejt tjetër gjë.

Erion Braçe – Jo, mor, ti nuk je armiku. Kush e tha? Ti je anëtar i komisionit.

Ervin Bushati – Unë thashë: kur të vijë kjo, dua të shoh shifrat.

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Erion Braçe – Më falni!

Zoti Bushati, është një çështje shumë specifike, e cila meriton të diskutohet...

(Ndërhyrje pa mikrofon)

Zoti Bushati, mos u vetëviktimizoni, se nuk kishte njeri për qëllim as t'ju rrihte, as t'ju kundërshtonte!

Është shumë e thjeshtë. Nesër është diskutimi në parim i ligjit "Për tatimin mbi të ardhurat" dhe atje mund të diskutojmë gjerë e gjatë, sepse natyrisht që ka shumë gjëra, ndër të cilat, përjashtuar një shtet në rajonin tonë, të gjithë të tjerët e kanë më të lartë normën e tatimit mbi të ardhurat nga dividendi se sa edhe kjo që po bëjmë ne. Dakord? Kështu që, është e mira t'i diskutojmë nesër të gjitha më në detaje.

Ka pyetje të tjera? Nuk ka.

Ka diskutime në parim lidhur me paketën fiskale?

Në qoftë se nuk ka, unë dua të them dy fjalë.

Dëgjova dje me shumë vëmendje komunikimin me median të bashkëdrejtueses së këtij komisioni, zonjës Jorida Tabaku, në raport me buxhetin e shtetit dhe paketën fiskale. Natyrisht, ka disa gjëra, që vlejnë të sqarohen para se të deklarohen, por ka disa gjëra, të cilat, natyrisht, kanë edhe elementin brenda të propagandës dhe të nevojës pikërisht për të bërë propagandë. Ajo që mbetet nga paketa fiskale, që qeveria ka paraqitur në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë jo vetëm tani, por edhe dy muaj e pak më përpara, ia vlen të theksohet se, në mënyrë të qartë, qeveria dhe kjo maxhorancë kanë bërë lehtësira të konsiderueshme për të gjitha fashat e sipërmarrjes në këtë vend, madje duke nxitur edhe sipërmarrje në krijim për t'u marrë me këtë aktivitet në territorin e Republikës së Shqipërisë.

Do të doja të thosha që ne vazhdojmë të mbajmë tatimfitimin zero lekë për të gjitha bizneset e vogla me xhiro vjetore deri në dy milionë lekë. Pra, të gjitha ato që konsiderohen realisht biznese të vogla vazhdojnë ta kenë zero lekë tatimfitimin.

Natyrisht, pas ndërhyrjes që ne bëmë jo më larg se para dy muajve, tatimi mbi fitimin për bizneset me xhiro mbi këtë fashë, pra, me xhiro nga 2 deri në 14 milionë lekë në vit, u ul në nivelin 5%. Kjo është një lehtësi e konsiderueshme fiskale për të gjithë atë fashë të sipërmarrjes që deri dje kishte dy probleme shumë të mëdha: rënien në paligjshmëri (u kemi hequr edhe barrën e të qenit i paligjshëm) dhe në evazion fiskal, për shkak të kalimit të fashave dhe rënies në një normë fiskale më të lartë se sa ajo në të cilën ndodheshin dhe në krahun tjetër, zgjerimin e aktivitetit të tyre, tashmë të ligjshëm, deri në nivelin e 14 milionë lekëve të xhiros vjetore me një normë 5%.

Ia vlen të theksoj se edhe në krahun e sipërmarrjes në bujqësi u bënë lehtësira të konsiderueshme fiskale, veçanërisht në normën e tatimit mbi fitimin, për të gjitha ato shoqëri të bashkëpunimit bujqësor dhe blegtoral, të cilat operojnë sot në fshat.

Po kaq lehtësi u bënë edhe në dy aspekte të tjera të rëndësishme. Së pari, në turizëm me vendosjen e TVSH-së 6%, por edhe në agroturizëm me një sërë lehtësirash që vijnë që nga tatimi mbi vlerën e shtuar deri te taksat që do të paguajnë për ngritjen e këtyre strukturave.

Kështu që, të thuash sot, pas gjithë këtyre hapave të qenësishme të ndërmarra deri tani, pa këtë paketë fiskale, që qeveria nuk e ka mendjen për të ndihmuar sipërmarrjen e vogël

dhe të mesme në këtë vend, është e pavërtetë, por, mbi të gjitha, është e padrejtë dhe e pandershme.

Paketa fiskale, të cilën e kemi në diskutim dhe do të miratojmë në javët në vijim, sjell lehtësira të tjera fiskale edhe për atë fashë të sipërmarrjes që hyn te sipërmarrja e madhe. Ulja e tatimit për të ardhurat nga dividendi ia vlen të përmendet në këtë pikë, pavarësisht mendimeve të mia personale, të Ervinit apo të kolegëve të tjerë, që do të vijnë t'i thonë edhe nesër dhe në vijim kur ligji do të diskutohet. Por, ama, është shumë e qartë që lehtësirat fiskale, në të gjitha fashat e biznesit, janë të qenësishme. Pa asnjë diskutim që mund të ketë përsëri njerëz të pakënaqur edhe nga këto masa fiskale. Për shembull, gjithë kategoria e atyre njerëzve që duan të bëjnë biznes në këtë vend pa paguar asgjë. Pra, të marrin gjithçka, duke filluar nga lehtësitë në kontrata, licenca, burime natyrore e të tjera me radhë, dhe të mos paguajnë asgjë. Pa asnjë diskutim që ka edhe modele të tilla, të cilat administrata fiskale duhet t'i adresojë duke filluar nga më të mëdhenjtë.

E kam thënë emrin e kompanisë, që ka 15 vjet që paguan zero lek tatimfitim në këtë vend. Përsëri, kur vjen momenti të lajmet, kurrë nuk i bëheni krah administratës fiskale dhe qeverisë në një betejë, e cila është betejë në interesin publik, që sjell para në buxhetin e shtetit të një aktiviteti që shfrytëzon pasuritë natyrore në këtë vend të ardhurat nga të cilat duhet të arkëtohen në interes të qytetarëve të RSH-së. Paketa fiskale e kësaj radhe adreson edhe problematikat që lidhen me të ardhurat nga rrogat për pjesën që është mbi 13-15 mijë lekë, që shkon në 130-150 mijë lekë dhe për pjesën mbi 150 mijë lekë.

Natyrisht, mund të ketë një diskutim konstruktiv dhe të hapur, sipas mendimit tim, edhe nesër kur do të diskutojmë këtë projektligj për pjesën e poshtme të pagave nën dritën e të gjitha masave që qeveria ka marrë deri tani për rritjen e pagave të ulëta të kësaj fashe, pra pagave të atyre që janë vërtet shërbyes publikë dhe janë punëtorë jo vetëm të shtetit, por edhe të sipërmarrjeve private.

Thënë të gjitha këto, pa asnjë lloj diskutimi, unë nuk kam si të mos ta ftoj opozitën që ajo të bëhet pjesë e një debati profesional këtu, në Komisionin e Ekonomisë, por për të thënë të vërtetë. Për gënjeshtër ky vend është i vleritur nga mëngjesi deri në darkë. Nëse duam të flasim për gjëra që kanë natyrën e fakteve, të numrave, të llogarive mbi to, jemi të hapur të diskutojmë këtu në Komisionin e Ekonomisë, kur të dëshirojnë ata, por siç e thashë, me fakte dhe natyrisht, edhe me shembuj personalë, sepse ka (po e përsëris për të disatën herë), deputetë

në Kuvendin e Shqipërisë që fitojnë edhe 10 milionë dollarë në vit për të cilët (kjo është rezerva që kam) as më shkon ndërmend që të ulet norma e tatimit, qoftë dhe të ardhurat nga dividendi, sepse kam parë që këta ndajnë edhe dividendë.

Kështu, ftesa mbetet e hapur. Të vijnë, të diskutojnë kur të duan në Komisionin e Ekonomisë dhe po të duan, për çdo rast konkret (tatimpaguesish apo komunitete tatimpaguesish), por me një kusht: të thonë vetëm të vërtetat.

Normat e tatimeve për të cilat ju fola, janë të materializuara në ligje. Ligjet janë bërë fakt, kështu këtu jemi, hajdeni të diskutojmë! Duke filluar nga nesër do të fillojmë të diskutojmë një për një të gjitha ligjet e paketës fiskale. Nesër kemi 3 projektligjet e para. Do të fillojmë me projektligjin për tatimin mbi të ardhurat, me projektligjin për tatimin mbi vlerën e shtuar dhe me projektligjin, që ka të bëjë me taksat kombëtare.

Në ditën në vijim do të diskutojmë 4 projektligjet e tjera të propozuara nga qeveria, që lidhen drejtpërdrejt me fiskun.

Pa asnjë diskutim, siç është tradita në këtë komision, do të dëgjojmë edhe sipërmarrjen dhe më pas, do të vendosim në fund fare me votë për cilindo profesion.

Mbledhja mbyllet këtu.

Do të ritakohemi nesër në orën 10:00 për të diskutuar në parim 3 projektligjet e para të paketës fiskale. Do të doja që t'i kishit gati pyetjet (nëse mundeni që sot), me qëllim që t'ia dërgojmë ministrisë për të qenë sa më konkretë edhe në numra, edhe në fakte. Faleminderit!

Komisioni do të qëndrojë edhe pak!

(Ndërhyrje pa mikrofon)

MBYLLET MBLEDHJA